



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 13**

**Datë: 04. 02. 2021. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve**

- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së;**

**Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Tingullit, Llogos, Sloganit dhe Dizajnit, për fushatën e informimit publik, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021**

- 4. Të ndryshme.**

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** E hapim mbledhjen e 13-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite? Po urdhëro Sami...!

**Sami Kurteshi:** Unë e mora rendin e ditës, kjo pjesë për mu është në rregull. Ne dje kemi diskutuar në mbledhjen e fundit të KQZ-së për dy çështje. Edhe unë kish propozua që të futen në të ndryshme. Çështja e parë është marrja e një vendimi për krijimin e një trupi, një grupi, një komisioni që përcjell postat nga mërgata, nga diaspora, që vinë në Kosovë ose nga jashtë Kosovës sidoqoftë, për gjitha veprimet dhe për të gjitha procedurat deri në KQZ-ë. Edhe vendimi tjetër që duhet të merret është d.m.th caktimi i datës 24 orë para ditës së zgjedhjeve për pranimin e postimit, e postës nga jashtë Kosovës. Kjo do të thotë deri në orën 19:00 me 13 shkurt deri në orën 19:00.

**Valdete Daka:** Po, urdhëro Burim...!

**Burim Ahmetaj:** Përpjekjen e parë, kërkesën e parë të Zotëri Kurteshi. Sekretariati ka marr masat me komunikua me postën e Kosovës, dhe me postat tjera të cilat janë të shpejta. Dhe kemi konfirmimin se të gjitha postat e shpejta duhet ti dërgojnë, postat në fahun postar që është fa për KQZ. I vetmi vend ku do të pranohen të gjitha zarfet me fletëvotime, do të jetë fahu postar në postën e Kosovës. Kanë mbete edhe çështjet teknike të ju dërgojmë edhe me shkrim, të gjitha postave, në mënyrë që ti adresojmë të gjitha zarfet në postën kryesore të Republikës së Kosovës. Mirëpo është çështje e formalit teknike, mirëpo konfirmimi është që do të shkojnë të gjitha zarfet atje.

**Sami Kurteshi:** Në një prej mbledhjeve këtu të KQZ-së, prej sekretariati vet na ka konfirmua që ka me u përdor përvoja e viteve të kaluara. Përvoja e viteve të kaluar ka qenë që KQZ-ja e cakton një zyre brenda për brenda , pak pa pas nevojë që këto postat e shpejta me i dërgua te fahu postar që për shkak të mungesave. Tash unë nuk jam i sigurt që këtu nuk ka me pas lëshime, s'kan nevojë me u ndal një stacion tjetër para se me ardh të stacioni i fundit. Në çiftë se postat e shpejta kanë për qëllim, krejt votat kanë për qëllime me ardh në QNR ose në KQZ konkretisht, pavarësisht prej hapësirës ku, atëherë ato duhet me ardh në KQZ. Se aty është destinacioni i fundit. Nuk kemi na nevojë me i caktua stacionet e radhës pa nevojë.

**Sami Hamiti:** Po pikërisht ata deshta ta them. Adresa e fundit edhe me postë të shpejt, edhe me postë të rregull, edhe me postë avio postë është fahu postal. Është posta numër 6 pahu i jonë. Pse postat e shpejta edhe tjera nuk dojnë, të shkojnë me i dorëzua atje sepse e kanë një element, një taks e shtesë a sa 10 cent, 15 cent ajo është çështje e atyre postave nuk është e jona. Pahu postar është ai, dhe çdo votë duhet

të shkojë atje. Nuk është rruga "MIGJENI" por është posta numër 6 pahu postal. Pikërisht nëse ndodhin këto, e vinë këto në vendet pa caktume për atë pjesë, atëherë mund të ketë probleme. Absolutisht, një pah postar është i KQZ-së ku adresa e saktë është i vetmja adresë ku duhet të mbërrijnë votat me postë është në pahun postar. Prandaj të gjitha postat të shpejta, mirë keni be që keni komunikua, mire që keni komunikua edhe me postën. Ato vota shkojnë në pahun postar ku e kanë de stinimin. S'ka posta e shpejtë, me thanë unë tash, jam ardh edhe e kom gjet, ketë vend po e la. Jo jo, aj e qon distilimin, s'ka qare pa e qua në distilimin ku është.

**Alim Rama:** Unë po e shoh diçka, ky është qëndrimi krejt i kundërt i kolegut Hamiti. Atëherë pse ka veprua në zgjedhjet e kaluara kështu? Unë kam konfirmim prej anëtarëve të tjerë, që kanë qenë këtu, që ka pas në zgjedhjet e kaluara. A jeni marr ju me postë apo është marr sekretariati? Le të na konfirmon sekretariati. Zgjedhjet e kaluara a ka qenë shpjegimi që na ka ardh këtu.

**Valdete Daka:** Nuk ka pas kurrfarë komisioni, brenda për brenda KQZ-së. Nuk ka pas komision që ka pranuar, zarfa as që ka be verifikim as kurrëgjë. Pra nuk ka pas komision. Unë qeta jam tu e thanë Alim. Në të ndryshme ajo pikë nuk bon me hy, shqyrtoni në KOZ edhe qitni.

**Alim Rama:** Sepse sekretariati nuk ka qenë i gatshëm me e thirr KOZ-in. Unë kërkova menjëherë KOZ-in edhe deshta unë me krye punën. Ju mundeni me bo edhe një pengesë shtesë, qysh keni provu me bo pengesa më herët. Nuk kanë nevojë... edhe nuk thotë në cilën KQZ-ja. I takon KQZ-së me i caktuar një ose ma shumë, nuk caktohet që është vetëm një. Në qoftë se unë nuk kam besim sepse raporti i GERMINIT ka dëshmuar që postat e Kosovës, nuk janë sjell në mënyrë korrekte në zgjedhjet e kaluara. Ka mungua vula detale. Është pune e GERMINIT ata e kanë be një studim se çka ka ndodh me zarfet e 2019-tës. Kështu që, mbase adresa e fundit është KQZ, pavarësisht kutia ku ka me qenë, qysh ka qenë praktika deri tash, kutia duhet me qenë këtu. Në mbikëqyrje të Policisë, edhe te krejt vëzhguesve. Nuk e di ku është problemi me pas kutin mbikëqyrëse të krejt vëzhguesve.

**Valdete Daka:** Problemi është që nuk ka pas praktik të tilla Alim. Nuk ka kuti brenda KQZ-së. Asnjëherë nuk ka pas kuti në KQZ, as nuk ka pas mbikëqyrje, as nuk ka pas komision asnjëherë. Të gjitha votat që kanë shkuar në fahun postar në postë ato janë marr, me përcjellje të Policisë, me vëzhgues, me krejt. Po, ajo praktika ka ekzistua, d.m.th vëzhguesit, Policia kanë qenë prezent të pahu edhe kanë përcjell zyrtarin e KQZ-së i cili ka shkua. Dhe subjektet që kanë qenë të interesume e kanë vëzhguar, edhe nën përcjellje të Policisë, ka shkua në vendin ku është destinua, ato në KQZ nuk kanë ardh kurrë. Kjo është selia e KQZ-së. Në KQZ nuk kanë ardh votat kurrë. Unë nuk e di ku e kë marr këtë informatë. Këtu në seli të KQZ-së nuk

kanë ardh vota. Votat të janë marr nga fahu postal, kanë shkua në QNR apo kudo që e kemi pas vendin e përcaktuar për me i mbledh votat nga posta. Ajo pra ka qenë praktika, pra nuk ka pas praktik që këtu në brenda KQZ-së me hap një kuti postare, apo me organizua një komision, apo me organizua një pranim, dorëzim të votave këtu në KQZ. Nuk ka ekzistua kurrë, jo përderisa jam këtu që 11 vjet. Nëse përpara ka qenë ajo është diçka tjetër.

**Eshref Vishi:** Mbledhjen e kaluar, u debatua për këtë pikë të rendit të ditës, për këtë çështje që u ngrit tani. U murr vesh që kjo çështje të trajtohet në KOZ në Këshillin për Operacione Zgjedhore mund ta debatoni atje. Ne të ecim me këtë rend ditë të cilin e kemi vetës këtu. Nuk do të thotë, kur ne e ngrinim zërin kemi ne shumë të drejt. Ose e zbulojmë një praktikë të re. Janë praktika që i dinë sekretariati, që i ka zbatua në zgjedhjet paraprake edhe është krejt në rregull që ti ndjekim ato praktika. Jo të zbulojmë diçka të re këtu sot.

**Burim Ahmetaj:** Vërtet nuk po e kuptojë këtë tendence meqenëse, edhe dje e diskutuam gjatë mbledhjes se KQZ-së. Këto pika dhe të gjithë e ngritëm shqetësimin tonë edhe në lidhje me votat e diasporës. Mirëpo, edhe me procedurat të cilat duhet të shkojnë ashtu siç rekomandon, edhe na obligon në një far forme edhe ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Dhe ne ligj është destivisht është qartë e shkruar, fahu postal, njëherit, edhe njoftimet e publike, të informimit publik, të këshillit për informim publik. E kanë miratua ato që janë të rregulluara me rregullore dhe të cilat janë të rregulluara edhe me ligj. Është çështje që mund ta diskutojmë në KOZ. Unë jam dakord, që ta diskutojmë këtë. Që të shoh formatin ma të mirë, të shoh formatin se si të rrisim transparencën, pra të shohim që se në çoftë se po vinë vërtet veturat zyrtare të postave, nuk po vinë veturat për peruan personale të njerëzve. Është shqetësim që e kamë ngrit unë edhe para disa jave, që ekziston edhe kjo mundësi. Që dikush të tentoj edhe të manipuloj, në emër të diasporës apo në emër të dikujt tjetër. Kështu që unë pres që edhe në këtë çështje të respektohen ligjet, të respektohen rregulloret, por e diskutojmë ne KOZ. Rekomandoj që të vazhdojmë me rendin e ditës, meqenëse edhe rregullorja e brendshme parasheh që nuk mund të debatojmë një pikë ende të pa propozuar. Na e patëm një çështje të ngritur këtu, thamë që ta diskutojmë të ndryshme. Tash ose jemi kundër ose jemi për? E diskutojmë të ndryshme, e lamë në fund mirëpo të vazhdojmë me atë se çka është ma e nevojshme edhe në lidhje me akreditimin e vëzhguesve, edhe në lidhje me pikat tjera që i kem në kuadër të rendit të ditës. Kështu që, kjo metodë që po praktikohet tash e sa javë, që debatohet në minutat e parë jashtë rendit të ditës, d.m.th neve po na shkojnë jashtë 40 minuta jashtë rendit të ditës. Jemi tu diskutua tema jashtë rendit të ditës që as nuk marrin aprovim, as nuk propozohen, qartë nuk shqyrtohen

në të ndryshme. I kemi propozimet, janë mundësit përmes shkresave, propozoni pikë të rendit të ditës, i diskutojmë. Por ti respektojmë, e para e punës rregullat e brendshme. Faleminderit.

**Alim Rama:** Jo, unë e diskutoj ata çka ma merr mendja mua, edhe unë i dëgjova krejt. Unë e bëra një propozim në fillim edhe kërkova në mënyrë të ligjshme edhe me rregullore që si respektoni asnjë. Që ose të futet në të ndryshme, ose të diskutohet. Edhe më duket nuk diskutova ma shumë se 1 minutë. Edhe që fakti po problematizohet kjo, vërtet tregon qëllimin. Unë propozova, edhe përsëri po e propozojë ne kemi diskutuar në mbledhjen e mbrëmshme që të diskutohet për krijimin e një grupi nga KQZ-ja dhe sekretariati ku janë përfaqësuesit e të gjithë partive politike, që të përcillet posta që vjen nga jashtë për KQZ-në, në çdo hap për të mënjeluar çdo mundësi të zvarritjes edhe të vonesave të postës. Kjo është propozimi i parë. E dyta, unë propozova edhe isha i qartë që KQZ të merr vendim që posta të pranohet deri në orën 19:00, me 13 shkurt, 24 orë para përfundimit të afatit të votimeve. Tash po e them edhe një çështje, sepse unë nuk dështua me e zgjatë. Qëllimi i dërgesës është me mbërriri në cak. Posta nuk ka tjetër kuptim edhe tjetër qëllim. A mbërriri këtu në zyre? A mbërriri në fahun postal? A mbërriri në QNR? Qëllimi është me ra në dorë të KQZ-së, posta e rregullt që është dërgua në mënyrë të rregullt. Edhe kërkesa e jonë është që me atë poshtë me e trajtua që është ardh në mënyrë të rregullt. Edhe krejt diskutimi, jo duhet me dërgua atje se këtu s'bon, se kjo është i kot. Qëllimi i një poste është me mbërriri te caku. Caku është KQZ. KQZ-ja duhet të pranojë çdo postë, që është postuar në mënyrë të rregullt. Çështjet po ngritën edhe nuk vendosen në rendin e ditës, në çoftë se u ngrit dje. Në çoftë se ka qenë kërkesa dje, d.m.th që ajo kërkesa duhet me u trajtua deri në mbledhjen e radhës edhe unë nuk e pash në rendin e ditës.

**Valdete Daka:** Ne u d akordua që kjo çështje të diskutohet në KOZ.

**Alim Rama:** A ka dikush problem që na me i pranua zarfet. Qëllimi është që ti pranoj zarfet. Edhe pika e dytë e rendit të ditës është dashtë me u diskutua në KOZ që e rekomandoj kolegu Samiu. Ajo nuk diskutohet në KOZ sepse është vendimi ma shumë i zyrës ligjore se sa vendimi i KQZ-së. Të pranohen të gjitha dërgesat që vijnë në Kosovë deri në orën 19:00, një ditë para zgjedhjeve.

**Ibrahim Selmani:** Edhe unë mendoj se duhet me pas transparencë, duhet me përcjell detyrimisht të gjitha zhvillimet dhe duhet me i përcjell edhe zarfet të cilat vijnë, edhe duhet me pas jashtëzakonisht kujdes në këtë drejtim. Një pyetje e kam për administratën. Ora 19:00 propozimi i Samiut. Çka është në rregull me orën 19:00 e çka nuk është në rregull në orën 19:00 si afat i fundit? A mundet me kanë a s'mundet me kanë? Ata kanë me na tregu. Ku është problemi për mu? Po i adresojmë na, po ja kthejmë. Krejt problemin edhe krejt fajësinë po ja kthejmë në KQZ. Edhe tash nëse dalim në qytet, fajtor për të gjitha zhvillimet

është KQZ-ja. D.m.th na po e bëjmë. Nëse është qëllimi këtu, atëherë është një problem në vetë që duhet me e diskutua edhe këta. Nëse flasim drejt edhe korrekt në mbledhjen e mbrëmshme, e kemi hap për diskutim këtë problem, dhe kemi vendos ta trajtojmë në KOZ. Në mbledhje të KOZ-it, Këshilli për Operacione Zgjedhore. Sikurse të ishin trajtuar këto pika, që janë të rëndësishme pa asnjë diskutim edhe pa dyshim. Tash kishim me pas na një trajtim edhe një organizim pak më të ndryshme të takimit. Na mundemi me e mbajte edhe një mbledhje si ta kryejmë tash të KQZ-së, ta mbajmë një mbledhje të KOZ-it edhe ta diskutojmë edhe ta qartësojmë.

**Valdete Daka:** Faleminderit Ibrahim. Unë e qes në votim rendin e ditës. Po urdhëro Artan?

**Artan Asllani:** Edhe e mora imellen prej Nexhit, që është bo nominimi i KVV-ve. Edhe aty pash shumë pa rregullsi sidomos në komunat ku jetojnë komuniteti Ashkali. Dy prej komunave që janë prek kogja shumë është Ferizaj edhe Prizreni. Këta zyrtarët nëpër KKZ, a janë interpretues të ligjit apo janë me na tregu neve a jem fajtor? A s’jem fajtor? E kom ngrit edhe këtë çështje të Nexhi. P.sh nëse shkojmë të Prizreni IRDK-ja me 13 vota, me 13 vota në krejt Prizrenin i merr 7 komisioner. Kurse partia e Ashkalive për integrim me 190 vota nuk e merr asnjë komisioner. E kemi PLE-n e cila ka veç pak vota, ma shumë se partia e Ashkalive për integrim edhe i merr 45 komisioner. Ose në Ferizaj e kem lëvizjen për bashkëveprim, e cila është parti për herë të parë, e cila kandidon për këto zgjedhje për parlament, i merr 17 komisioner dhe partisë së Ashkalive për integrim e cila është e përfaqësuar edhe ne komunë edhe është e përfaqësuar në parlament, ju hjekën komisionerët dhe ju vendosen PDAK-së dhe lëvizjes për bashkëveprim. Kur na e dimë edhe kësaj here, edhe partia Balliste, edhe partia Fjala nuk janë të përfaqësuar në kuvend asnjë komisioner e në asnjë komunë nuk kanë marr. Na si parti parlamentare jemi te dëmtuar. Në bisedim me zyrtarin në Prizren, zyrtari e pranon nominimin e partisë së Ashkalive për Integrim edhe nuk e dërgon në KQZ hiq. Nuk e dërgon tek Nexhi hiq. Unë kom pas kërkesë, pasi nuk jam pjesë e KOZ-it, kam pas kërkesë edhe te disa anëtarë që janë pjesë e KOZ-it me e shqyrtua këtë çështje. Kom pas kërkesë edhe te Nexhi të njëjtën kohë por nuk është marr parasysh asgjë.

**Ibrahim Selmanaj:** Është çështje e vërtet të cilën e ka adresua Artani edhe gjatë ditës së djeshme, mirëpo edhe para ditës së djeshme që të ketë parasysh meqenëse e ka potencua disa herë faktin që nuk po përcillet ajo kërkesë e partisë së Ashkalive për integrim. Edhe unë mendoj që një kërkesë e tillë, në qoftë se Artani veç e ka, është mirë që të na propozojë si këshill i operacioneve zgjedhore dhe bashkërisht ta trajtojmë. Edhe ta rekomandojmë për aprovim, meqenëse edhe unë vërtet mendoj, është bërë një padrejtësi, ndoshta edhe prej kohës së kufizuar që e kemi pas dje. Njëjtë ka ndodh edhe me rastin KDDP-së e po besoj që këtë çështje mund ta trajtojmë në Këshillin për Operacione Zgjedhore. Na dje, bashkërisht

edhe me zotëri Rama edhe anëtarët e tjerë të Këshillit për Operacione Zgjedhore, e kem trajtuar, e kem votuar edhe në fund e kemi rekomandua edhe për KQZ-në që ti miratojë, mirëpo ka qenë një kohë e shkurtë për të cilën, aty këtu ka muajt me pas lëshime të cilat realisht në fund kanë sekuenca në ditën e zgjedhjes. Kështu që unë po besoj se si kërkesë, do ti propozohet KOZ-it edhe KOZ ta trajtojë këtu, bashkë me drejtorin e terrenit. Faleminderit.

**Rifat Krasniq:** Edhe, unë e kam qashtu përkrah zotëri Artanin, që e ka propozimin qashtu. Është i pari në Prizren, KDDP-ja qashtu. Është partia e 4 e cila, Qemajli i 5-ti. Edhe e kom një propozim në Mamushë. P.sh këtu LDK-ja ka 3 anëtarë, por që duhet me qenë 4. Edhe NISMA nuk ka kryesues. NISMA i ka 200 vota, VV i ka 2 vota. VV me qenë aty kryesues, a NISMA jo. Për ata duhet me ndryshua këta. Faleminderit.

**Alim Rama:** Nuk kisha pas qejf me ndërhy në komunitat e veçanta. Na si këshill edhe në parim jemi pajtuar, që kryesuesit e këshillave të vendvotimit me qenë sipas ligjit. Të 4 partive të subjekteve politike që kanë fituar ma së shumti vota në ato komuna. Pjesa e dytë ka qenë, për shkak të pandemisë. Në Prizren ka pas nominime 11-të, 12 anëtarë në një këshill vendvotimit. Kërkesa ka qenë secili vendvotim mos me pas ma shumë se 7 anëtarë, nuk ja kemi dhënë numrin sekretariatit, sa me u zvogëluar por mu zvogëluar në proporcion që minoritetet, të jenë prezentë në ato vendvotime ku janë prezentë. Se s'ka pas nevojë që p.sh KDDP-ja konkretisht ka pas komisioner në secilin vendvotim. Na e dina, unë po flas për Prizren tash, masi Prizreni u hap. Na e dimë që KDDP-ja është e hapur vetëm në qytet. Kërkesa ka qenë edhe në ato vende ku janë, në vendbanime ku ka ma shumë vota që të bëhen me rotacion. Që mos të tejkalohet numri prej 7 dhe kështu që prezenca e një partie së komuniteteve në KQZ nuk duhet mu keqkuptua si dominant ndaj subjekteve tjera që garojnë. Unë s'po dua me hy ne detaje, unë po shoh pa drejtësitë. Unë po mendoj që padrejtësitë janë adresua, do të duhet me u adresua prej sekretariatit në qoftë se ka. Sepse na nuk jemi marr me numrin e secilit, por vetëm kemi kufizua pjesëmarrjen. Kështu që na nuk jemi marr, me formulat. A ka me pas KDDP-ja a VAKAT a PAJ diku tjetër. Neve, e kemi këqyr rezultatin në komunë d.m.th, ato 4-5 partitë e komuniteteve që marrin pjesë në qatë komunë, ti kanë me rotacion ku kanë nevojë, ku s'ka nevojë. Kane me u krijua një balancë, qysh kërkohen në bazë të ligjit.

**Artan Asllani:** Kërkoj falje që e ngrita këtë çështje po, e kam ngrit në të gjitha instancat. Kom fol me Nexhin, jam mundu edhe në Këshillë për Operacione Zgjedhore por nuk shkojë kërkun, edhe u deshtë patjetër unë me ngrit këtu. Fatkeqësisht Alim edhe pse jam unë i partisë së Ashkalive për Integrim. Përfaqësues, anëtarë i KQZ-së në të gjitha komunitat jam i dëmtum. Në të gjitha komunitat, të gjitha partitë tjera kanë komisioner ma shumë se partia e Ashkalive për Integrim. Duke u bazuar edhe në Prizren edhe në Ferizaj. E keqa e jonë është e krejt se herë po thirrem në parime e here po thirrem në ligj. Duhet

vazhdimisht me u thirr ose në parime ose në ligj. Edhe zyrtarët komunal që janë, ata pe marrin d.m.th automatikisht pi shohin debatet tona edhe po reflekton edhe te ta keq. Here po thirren në parime, dhe po i interpretojnë ligjet varësisht prej situatës. Po i konvenon situata me afrua PLE-në, p'i dhajnë komisioner PLE-së ma shumë. Duhet me u thirr ose në parime ose në ligj. Me zgjedh njanjën prej tyre e jo herë ashtu e herë kështu.

**Alim Rama:** Kjo ka krijuar një keqkuptim. Jemi pajtuar në parim në bazë të ligjit. D.m.th jo njëra ose tjetra por, në bazë të ligjit. Kështu që, unë se pata me Artanin ma shumë e pata me KDDP-në. Se KDDP-ja i ka pas në Prizren 216. Se 216 komisioner i ka nominuar KDDP-ja në Prizren. D.m.th nga një nëpër secilin vendvotim. Edhe ajo ka qenë e pa drejtë, kështu që na kemi kërkuar vetëm të zbatohet formula. Kurrgjë tjetër nuk kemi hy në asnjë parti, baza ka qenë numri i votave në atë komunë.

**Artan Asllani:** Te Prizreni kryetare, as nuk ka formulë, as nuk ka parim, as nuk ka ligj, nuk ka kurrgjë hiq.

**Valdete Daka:** Po shihet që ka nevojë KOZ-i me u taku edhe njëherë edhe ato shqetësimet që i keni, i adresoni. Ndoshta kish me qenë mirë që të gjithë bashkë, me u ulë edhe mi sqarua edhe një here edhe me dal. Nëse ka ndryshim në emërimin e komisionarëve me na propozua edhe aprovohet. Atëherë unë e qes në votim rendin e ditës më në fund në qoftë se mundemi? Në qoftë se mundemi diqysh me aprovua, ashtu siç është. Edhe në të ndryshme ato që u propozuan nga Samiu. Kush është për, pra këtë rend dite? Miratohet rendi i ditës...

## **2.Aktivitetet e ZRPPC-së**

### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve**

**Yll Belushkaj:** Para jush i kemi paraqit edhe rekomandimin e 5-të me radhë për akretim të vëzhguesve. Ky grup i përmban 258 vëzhgues, të cilët janë të ndar për secilin entitet një nga një. Duke fillu nga e para, Telegrafi me 12 vëzhgues, pastaj kemi media ndërkombëtare Roiters me 5 vëzhgues, Listën serbe me 45 vëzhgues, OJQ vendore Lestllërn me 45 po ashtu, media ndërkombëtare Alxhazira Ballkanas me 8, Partia Demokratike E Kosovës është ky grupi i dytë i vëzhguesve nga ta mesin nga ta me 38 vëzhgues. Media vendore Kosova Sot i ka 4 vëzhgues, si dhe media ndërkombëtare Doiche Press Agentur me 1 vëzhgues. D.m.th këta si total janë 258 e ndërsa deri tash kemi pranua 14.33 aplikacione për vëzhgim, ndërsa nëse aprovohet ky rekomandim bëhen të akredituar 253. Jemi tash tu u marr me grupe ma të mëdhaja të cilët vinë nga subjektet e mëdha politike, kështu që së shpejti do ti kemi edhe ata 10.000 tjerët. Është shumë



e rëndësishme të ceket para jush që afati i fundit për aplikim është nesër në ora 18:00 kështu që presim të gjitha subjektet politike të interesuara ti sjellin aplikacionet e tyre. Përndryshe pastaj do të jenë të pa afatshme.

**Valdete Daka:** Kush është pra që të akreditohen media vendore Telegrafi me 12 vëzhgues. Kush është për? Mirë. Kush është për që të akreditohen 5 vëzhgues të medias ndërkombëtare Reuters? Kush është për? Faleminderit. Subjekti politik Serbska Lista me 45 vëzhgues, OJQ vendore Lestllërn me 45 vëzhgues, Media ndërkombëtare Alxhazira Ballkans me 8 Vëzhgues, PDK me 138 vëzhgues, media vendore Kosova Sot me 4 vëzhgues dhe media ndërkombëtarë si dhe media ndërkombëtare Doiche Press Agentur me 1 vëzhgues. Vazhdojmë me pikën tjetër, raporti i këshillave.

### **3.Raport i Këshillave të KQZ-së;**

#### **Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

Shqyrtimi dhe miratimi i Tingullit, Llogos, Sloganit dhe Dizajnit, për fushatën e informimit publik, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021:

**Artan Asllani:** Sot, këshilli për informim publik. E kemi mbajtur mbledhjen e 4-të me radhë, ku në këtë mbledhje u diskutua për tingullin e zgjedhjeve. Operatori i ka pas disa propozime. Ne si këshill e kemi përzgjedhur tingullin e parë nga operatori.

**Alim Rama:** Unë mendoj që zyra ligjore ka interpretuar keq kontratën. Na, i kemi pagu shërbimet për tingullin e zgjedhjet e kaluara. Kisha kërkuar që edhe një herë të bëhet rivlerësimi. Se tingulli që u ble për zgjedhjet e kaluara, kishë dashtë me qenë si opsion edhe tash. Se kjo është një tjetër, është praktik që institucioni të justifikohet me një titull.

**Valdete Daka:** Nuk e kemi bo sepse çdo palë zgjedhje e ka logon e vet, shenjën e vet, sloganin e vet të veçant. qdo palë zgjedhje është ndryshe llogo.

**Alim Rama:** Roli jonë, është identik për zgjedhjet.

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për këtë tingull të këtyre zgjedhjeve? Kush është kundër? Kush apstenon? Aprovohet. Vazhdojmë me çështjen tjetër...

**Artan Asllani:** Pika tjetër që e kemi diskutua në këshillin për informim publik ka qenë logo dhe slogani i cili do të përdoret për të gjitha produktet që në vazhdim për promovimin e zgjedhjeve. Edhe për logo nga operatori ka pas disa propozime. Propozimi për logo i cili është zgjedh është kjo. Edhe na rekomandojmë për aprovim. Edhe slogani ka propozime disa slogane po mbase të një debati që e kemi zhvillu në këshill për informim kem vendos, që e kemi ndërrua krejt komplet prej propozimeve që kanë qenë prej operatorit. Edhe slogani i cili do të përdoret për zgjedhjet e 2021-ës është: “VOTO PËR VENDIN E KOSOVSËS.” Jemi mundu mos me iu përngja asnjë partie politike edhe e vetmja mënyrë ke kjo me i ik.

**Sami Kurteshi:** Unë kisha dashtë, nëse mundeni atë logon e mëparshëm me e kthye që ishte me.. Data po me duket e vogël . Unë prej kësaj pozite, tash a ju duket njerëzve shumë e vogël. Unë për vete, nuk po e shoh...

**Alim Rama:** Është jashtë kërkesave që e kemi pas në këshill. Kërkesa në këshill ka qenë 14 shkurt 2021, poshtë me qenë si e madhe. Ajo ka qenë që u aprovua në këshill për Informim Publik.

**Valdete Daka:** Atëherë meqenëse të gjithë po pajtohen, që zgjedhjet me qenë lart e parakohshme për kuvendin e republikës së Kosovës , brenda këtyre 2 vijave dhe nën këtë vijën e dytë me qenë 14 shkurt 2021 në madhësinë e shkronjave. Kështu që, në qoftë se pajtoheni të gjithë. Kush është për?

**Artan Asllani:** Edhe është propozimi për poster, edhe për poster kanë qenë dy propozime. Na kemi mëndu këta me Lland Kepin, ka pas ma shumë informata.

**Valdete Daka:** Atëherë për dizajnë kush po pajtohet? A kemi ndonjë pikë tjetër. Në të ndryshme më duket se i diskutuam. Po urdhëro.

**Sami Hamiti:** Për çështje e kohës sepse tërë kohën po përmendet. Të definohet me ligj qysh është, edhe me interpretimet që është ligjit. E kemi pas në interpretimet e PZAP-së, dënimet e subjekteve kur nënkuptohet 24 orë edhe është 24 orë paraditës. Prandaj është mirë me lyp interpretim prej PZAP-së. Na mundemi me bo data sa të doni. Por ligji e përcakton që është 24 orë para ditës së votimit. Jo përfundimit të votim kjo që po përmendet. Ajo ka qenë dilema, se a do të jetë ora 19:00 e mëngjesit, para fillimit apo para orës 24:00. PZAP-ja e ka dhënë orën 24:00, pra na flasim për një orë apo afat i cili nuk na takon fare neve se është e përcaktume me ligj.

**Sami Kurteshi:** Unë e propozova këtë edhe mendoj që edhe në propozimet që i kam dhënë edhe për datën e kandidatëve me 14 shkurt kanë drejt të zgjidhen edhe propozimet e tjera, i mbështes në ligjin për procedura administrative edhe në ligjin për procedurën e gjykatave të pranimit të dokumenteve, edhe

fundi i orarit është fundi kur pritet marrja e një dokumenti. Edhe ajo është ora 19:00 me 13 shkurt, 24 orë para përfundimit. Edhe PZAP-ja që ka rrëshqit disa herë, e sidomos sa i përket afateve edhe gjykata supreme e ka vendos të kundërtën. Prandaj unë propozimin e kam dhënë duke i konsultuar edhe ligjin për procedurën administrative, edhe ligjin për gjykatat edhe për pranimin e dokumenteve, edhe për dërgimin e dokumenteve në mënyrën datat, vulat. Kjo është ajo çështje që unë e kërkoja. Gjykata kushtetuese ka kërkuar që momenti i fundit që është 24 orë para ditës së votimit. Edhe këtë interpretim nuk besoj që ka me e bë ndryshe përveç përcaktimi të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative që i cakton afatet, datat, kohën edhe të gjitha.

**Alim Rama:** Tendencë me i paraqit vendimet e PZAP-it, me i interpretu pa kurrfar logjike ato po i shoh. Me vetëm një qëllim se sa me ia kufizu më shumë? Jena kufizu me të 2-tin, tash po dojmë me ja kufizu në mëngjes , 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Qka mundet me ndiku një zarf i mbyllur, me u tërhjek në kuti 24 orë para përfundimit të fletëvotimit.

1. Mirë që e ngritëm këtë sepse edhe në këshillin për informim publik gjithmonë po kem telashe për këto afate. Unë po e kuptoj shumë mirë Samiu edhe Alimin. Besoj që të gjith na kemi qef me ju dhanë mundësi, të gjitha atyre që kanë apliku me i pru votat në Kosovë. Jo me ja shty me 13-tin a me 14 a 15 , po është esenca që na çdo here këna dal. Na e kina aprovua një plan operacional. Në plan operacional është e përcaktuar data, kem aprovu edhe tekste këshillin për informim. Spoti veq është tu u punuar prej operatorit për votim përmes potës. Është mirë me gjithë respektin për të gjithë anëtarët po, është mirë mos me i dhanë konfuz, mos me i bo konfuz votuesit prej jashtë vendit jo 12, jo 13. Edhe këto zgjedhje vazhdojnë me planë operacional qysh e kem pas e në zgjedhjet lokale që i kem atëherë mundemi me i lyp edhe prej PZAP-ës edhe prej kushtetues, me lyp interpretim prapë edhe me punu.

**Sami Kurteshi:** Megjithatë ju keni bërë një plan operacional që na nuk e kemi pa. Ne kemi thanë 24 orë para ditës së zgjedhjeve sipas aktgjyimit të gjykatës kushtetuese edhe kurgjo s'kemi caktuar as një datë tjetër. Edhe 24 orë para ditës së zgjedhjeve, sipas aktgjyimit është momenti i fundit kur mbyllet vendvotimet ora 19:00, 13 shkurt. Nëse e keni shkruar këtë datë kështu po pajtohem , po përndryshe unë skam pa datë.

**Alim Rama:** Plani operacional për ata nuk është votu, për shkak të këtyre interpretimeve edhe i takon KQZ-së me e vendos.

**Sami Kurteshi:** Ne po kërkojmë që me sjelljet e veta KQZ të mos pengoj votuesit që ta shprehin vullnetin e tyre me votë. Tash është fjala për votuesit nga diaspora edhe po e shihni tendencën që çdo sekondë,

çdo minutë të vidhet nga koha e tyre me 2 shkurt në orën 00:01 minut është dashtë që fletëvotimet të jenë të gatshme. Nuk kanë qenë janë marr mi 20 orë tash kërkohen edhe nja 24 orë tjera, tu vidhen nga koha edhe ashtu e stërshkurtuar për dërgimin e postës, duke i marr parasysh edhe rrethanat me COVID. Shiheni tendencën prandaj nuk duam ti diskutojmë këto çështje publikisht por duam ti nxjerrim me votat, që kanë qenë vazhdimisht qysh kanë qenë edhe janë marr vendimet në kundërshtim me çdo ligj sikurse ka marr edhe PZAP që e shpall ligjin për zgjedhje lekspecialisht ndaj kodit penal. D.m.th që janë jurist që lidhje nuk kanë me ligjin edhe me kushtetutën edhe me asgjë. Prandaj ju bëjë ftesë të gjithë mërgimtarëve le ta dërgojnë votën e tyre edhe ne do të bëjmë përpjekje që së paku këto orë të mos i vidhen as nga KQZ e nga askush tjetër...